



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
University "Ukshin Hoti" Prizren

 Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar më dt.	05.09.2022
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	01-390

KËSHILLI DREJTUES

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.unl-prizren.com

Kryesues i Këshillit Drejtues
Prof. Asoc, Dr. Arif Murrja

Prizren, më 05.09.2022

Në mbështetje të nenit 17, 44 dhe 73 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, sipas referencës nr. 04-V-621, datë 30 maj 2013, duke u bazuar në nenin 3 të Rregullores për zgjedhjet e përgjithshme në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren, me nr. Prot. 01-380, të datës 01.09.2022, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prizrenit në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

- Shpallen zgjedhjet e përgjithshme në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren, për organet drejtuese si në vijim:
 - Këshillat e Fakulteteve;
 - Dekanët e Njësive Akademike;
 - Anëtarët e Senatit.
- Zgjedhjet e përgjithshme zyrtarisht fillojnë nga data 19.09.2022 dhe përfundojnë më 30.09.2022.
- Zgjedhjet në Universitet organizohen në të gjitha fakultetet për kategoritë si në vijim:
 - Anëtarët e këshillave të fakulteteve nga radhët e profesorëve;
 - Anëtarët e këshillave të fakulteteve nga radhët e asistentëve;
 - Anëtarët e këshillave të fakulteteve nga radhët e personelit jo-akademik;
 - Anëtarët e Senatit nga radhët e personelit akademik;
 - Anëtarët e Senatit nga radhët e personelit jo-akademik (Zgjedhjet për anëtar të Senatit nga radhët e personelit jo-akademik do të mbahen edhe në Administratën Qendrore të Universitetit).
- Çdo anëtar i Këshillit të Fakultetit ka të drejtë të propozojë një kandidat/e për pozitën e Dekanit.
- Vetëm dy kandidatët më të votuar nga anëtarët e KF mund të nominohen si kandidatë për Dekan për t'u zgjedhur në Senat.
- Personeli në marrëdhënie të rregullt pune nuk ka të drejtë për t'u zgjedhur në pozita udhëheqëse menaxheriale (Dekan dhe prodekan i njësisë akademike) nëse për arsye të

pensionimit nuk do të jetë në gjendje ta mbaj së paku 50 +1 % të mandatit, pozitën për të cilën aplikon.

7. Udhëzohen organet përkatëse të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, që ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve të përgjithshme, në përputhje me këtë vendim, Rregulloren për zgjedhjet e përgjithshme në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren, me nr. Prot. 01-380, të datës 01.09.2022, dhe legjislacionin në fuqi.
8. Të gjitha palët të cilat angazhohen në këtë proces zgjedhor duhet të tregojnë korrektësi dhe veprojnë në përputhje me vlerat demokratike.
9. Ftohen të gjithë përfaqësuesit e shoqërisë civile të Republikës së Kosovës, KQZ, OSBE, misionet diplomatike në Kosovë si dhe të gjitha mediat elektronike dhe të shkruara të Kosovës që të jenë vëzhguese dhe të monitorojnë zgjedhjet e përgjithshme në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren.
10. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prof. Asoc. Dr. Arta Murqija

Kryesues i Këshillit Drejtues



Vendimi t'u dërgohet:

- Këshillit Drejtues;
- Menaxhmentit;
- Njësive akademike;
- Zyrës ligjore;
- Personelit të Universitetit;
- Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- Arkivit.